



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:010256

Datë: 13.07.2021

Numri i dokumentit: 01990066

**P.nr.101/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja Diana Sina, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. M. nga Peja, për shkak të veprës penale asgjësim, dëmtim ose heqje e paisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.5 lidhur me par.3 dhe par.2 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP/II.nr.1618/2020, të datës 23.02.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën **07.07.2021**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Dëshire Jusaj, të akuzuarit B. M., të dëmtuarit N. K., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.13.07.2021 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **B. M.**, nga i ati D. dhe e ëma Z. e gjinisë G., data e lindjes . . . në Lublanë Slloveni, me vendbanim në Pejë, Rr. “. . .”, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i martuar-atë i 2 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, me numër personal . . .

**Ë s h t ë f a j t o r:**

**Sepse** Me datë 12.11.2020 rreth orës 10:00, në rr.”. . .” në Gjakovë, saktësisht në vend punishten e kompanisë “V. I.”, me seli në Gjakovë, i pandehuri B. M., menaxher dhe përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në vendin e punës, nga pakujdesia, edhe pse ka qene i vetëdijshëm se pasoja mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij, me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet, i pandehuri ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragraf 1 të ligjit 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, përfshirë edhe masat e parandalimit të rrezikut me pasoj lëndim serioz në punë, ku si pasojë e mos ndërmarrjes së masave të sigurisë në punë - përdorimi i pajisjeve adekuate mos vendosja e xhamit mbrojtës që nuk lejon qasjen e të punësuarit në atë pjesë, dhe më këtë rrezikon jetën e të dëmtuarit N. K., atë mënyrë që ditën kritike deri sa i punësuarit-dëmtuari, ishte në repartin vertikal të shpuzës duke punuar, ka ardhë deri tek prerja e gishtit të dorës së djathtë (gishti i mesit), si dhe lëndimi i një gishti tjetër të së njëjtës dorë (gishti i parafundit i katërt), me ç`rast i dëmtuari N. K., pëson lëndime të renda trupore, që paraqesin amputim e falangut distal të gishtit 3 dhe 4 të dorës së majtë, lëndime këto të përshkuara më hollësisht në akt ekspertimin mjeko ligjorë të Dr.M. G., i dt.13.01.2021.

- Me çka ka kryer veprën penale, Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 paragraf.5 lidhur me paragraf.3 dhe paragraf.2 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,38,39,46,47,48,49,69,70 nenit 358 paragraf.5 lidhur me paragraf.3 dhe paragraf.2 të KPRK-së, i shqipton:

### **DËNIM ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **10(dhjetë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej **30.00 Euro**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **30.00 Euro**, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari N. K. nga Gjakova, nuk është udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike pasi që e njëjta është tërhequr nga e drejta për të kërkuar kompensim të dëmit.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1618/2020, të datës 23.02.2021, kundër të akuzuarit B. M. nga Peja, për shkak të veprës penale asgjësim, dëmtim ose heqje e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.5 lidhur me par.3 dhe par.2 të KPRK-së, duke propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas Ligjit.

I akuzuari B. M. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaron: se pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohem, ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës për të cilën veprë jam penduar pa masë, shton se unë jam mbikëqyrës i punëtorëve në kompaninë "V.I." dhe ditën kritike unë nuk kam qenë në vendin e ngjarjes, respektivisht në repart, posa më kanë lajmëruar punëtorët tjerë unë menjëherë kam ardhur në vendin e ngjarjes dhe të dëmtuarin N. K. n e kam dërguar në emergjencën e spitalit në Gjakovë, për të ia dhënë ndihmën e parë, tani i dëmtuari është shumë më mirë, punon në të njëjtën firmë, mirëpo edhe gjatë kohës kur është trajtuar ky ka marr kompensimin, ka marr rrogën si dhe nga sigurimi i firmës ka marr kompensimin për shërim, tani përsëri punojmë së bashku, nuk kemi asnjë mosmarrëveshje në mesë veti, shton se jam punëtor, mbajtës i vetëm i familjes si dhe për herë të parë paraqitem në gjykatë për një veprë të kryer penale por premtoi se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i propozoi gjykatës që të ketë parasysh këto rrethana dhe të më shqiptoi një dënim më të butë.

I dëmtuari N. K. në shqyrtimin fillestar deklaron: se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk kërkoj kompensim dëmit, B. e kam kolegë por e kam edhe shokë, punojmë së bashku që nga viti 1999, menjëherë pas rastit i njëjti më ka dërguar në emergjencën e spitalit dhe vazhdimisht është kujdes për shëndetin tim, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh këto rrethana dhe të njëjtit ti shqiptoi një dënim sa më të butë, shton se tani me shëndet ndihem shumë mirë, dorën e majtë e kam në funksion, me të njëjtën mund të punoi, nuk ndije dhimbje dhe nuk kam asnjë problem që të punoi.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Prokurorja e Shtetit Dëshire Jusaj nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të

akuzuarit pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vullnet të plotë, pa presion i njëjti paraprakisht ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat dhe faktet që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari B. M.: Me datë 12.11.2020 rreth orës 10:00, në rr.”. . .” në Gjakovë, saktësisht në vend punishten e kompanisë “V. I.”, me seli në Gjakovë, i pandehuri B. M., menaxher dhe përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në vendin e punës, nga pakujdesia, edhe pse ka qene i vetëdijshëm se pasoja mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij, me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet, i pandehuri ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragraf 1 të ligjit 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, përfshirë edhe masat e parandalimit të rrezikut me pasoj lëndim serioz në punë, ku si pasojë e mos ndërmarrjes së masave të sigurisë në punë - përdorimi i pajisjeve adekuate mos vendosja e xhamit mbrojtës që nuk lejon qasjen e të punësuarit në atë pjesë, dhe më këtë rrezikon jetën e të dëmtuarit N. K., atë mënyrë që ditën kritike deri sa i punësuarit-dëmtuari, ishte në repartin vertikal të shpuzës duke punuar, ka ardhë deri tek prerja e gishtit të dorës së djathtë (gishtit i mesit), si dhe lëndimi i një gishti tjetër të së njëjtës dorë (gishtit i parafundit i katërt), me ç`rast i dëmtuari N. K., pëson lëndime të renda trupore, që paraqesin amputim e falangut distal të gishtit 3 dhe 4 të dorës së majtë, lëndime këto të përshkruara më hollësisht në akt ekspertimin mjeko ligjorë të Dr.M. G., i dt.13.01.2021.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është baba i dy fëmijëve, mbajtës i vetëm i familjes, pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm për sigurimin e masave mbrojtëse punëtorëve gjatë punës, sjelljet e tij tejet korrekte në gjykim, kërkim falje të dëmtuarit, kompensimin për shërimin e të dëmtuarit, pajtueshmërinë e tyre, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin, duke mos gjetur rrethana rënduese, Gjykata në bazë të këtyre rrethanave ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimin i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 453 të KPPK-se, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**P.nr.101/21 me datën 07.07.2021**

**Sekretarja juridike**  
**Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,**  
**Diana Sina**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:010256  
Datë: 13.07.2021  
Numri i dokumentit: 01990066